

fondazione **sanzeno**



CENTRO
INFORMAZIONE E
EDUCAZIONE ALLO
SVILUPPO **ONLUS**



TJETER VIZION

AKSIONI I TE RINJVE PER NDRYSHIM

NJE PROJEKT I FINANCIUAR NGA FONDACIONI SAN ZENO VERONA DHE ZBATUAR NGA SHOQATA TJETER VIZION ELBASAN NE PARTNERITET ME ORGANIZATEN CIES ROME



www.fondazione sanzено.org

Verona, Itali

Fondacioni San Zeno kontribuon që kontribuon për institucionet dhe shoqatat që kryejnë edukim, trajnim njerëzor dhe profesional dhe punojnë në Evropë, Azi, Afrikë dhe Amerikë Latine. Ideja e Fondacionit San Zeno u themelua në vitin 1999 nga vullneti i një sipërmarrësi, Sandro Veronesi, president i grupit Calzedonia. Që atëherë kultivojmë të njëjtën dëshirë: të jemi nxitës të një ndryshimi, të vërtetë dhe të përbashkët, duke ofruar mundësi konkrete që përmirësojnë cilësinë e studimit, krijojnë mundësi për trajnim dhe mundësi për të ndërmarrë një punë.

www.tjetervizion.org

Elbasan, Shqipëri

Tjeter Vizion nga viti 2001 ofron shërbime sociale për fëmijë, të rinj, gra dhe vajza të ekspozuara ndaj rrezikut duke i ndihmuar në zhvillimin e tyre personal dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri. Fushat kryesore të intervenimit janë: qeverisja e mirë, trajnim profesional, çështjet gjinore, ndërmarrje sociale, turizmi, bujqësia, arsimiti.

www.cies.it

Rome, Itali

Misioni i CIES është të promovojë vlerat e solidaritetit dhe bashkëpunimit edhe në Itali dhe jashtë shtetit. Fushat kryesore të veprimit të saj janë: komunikimi dhe sensibilizimi i dialogut ndërkulturor, menaxhimi, arsimiti për çështje gjinore, trajnimi profesional për punë adekuatë.

AKSIONI I TE RINJVE PER NDRYSHIM

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Përmirësimi i kushteve të jetesës së të rinjve të Bashkisë së Elbasanit që jetojnë në kushte të cenueshmërisë, duke mbështetur integrimin e tyre të punës dhe përfshirjen sociale.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

- 1) Nxitja e punësueshmërisë së të rinjve të Elbasanit, nëpërmjet trainimit profesional dhe fillimit të bizneseve mikro-individuele.
 - 2) Promovimi i përfshirjes sociale të të rinjve të Elbasanit përmes rritjes së aftësive të tyre personale, relacionale, krijuese dhe sociale.
-

PËRFITUESIT DIREKT

400 të rinj marrin shërbimet e informacionit dhe orientimin e punës

120 punëkërkues të rinj marrin orientim në punë dhe trajnimi profesional

40 të rinj marrin "trajnim në punë" përmes dhënies së granteve


6 të rinj të mbështetur për fillimin e makro bizneseve

450 të rinj marrin pjesë në aktivitete rekreative

90 të rinj ndjekin laboratorë artistike

90 përfaqësues publikë dhe privatë përfshihen në aktivitetet e rrjetëzimit

25 përfaqësues të Qendrave Rinore marrin pjesë në rrjetin rajonal rinor



INFORMIM DHE ORIENTIM PËR PUNËSIM NË BAZË TË KËRKESAVE TË TREGUT TË PUNËS

Përmes hapjes së një SPORTELI TË ORIENTIMIT PËR PUNËSIM për punësim do të implementohen shërbimet në vijim, që të jenë në gjendje të mbështesin të rinjtë në rrugëtimin e tyre drejtaftësimin dhe përfshirjes në punë:

Shërbime informimi: do të ofrojë një bankë të dhënash mbështetur mbi ofertat e punës e të formimit profesional.

Shërbimi i Orientimit drejt punësimit: do të ofrojë mentorim të personalizuar për të nxjerrë në pah aftësitë personale e sociale të të rinjve dhe kompetencat e tyre profesionale dhe/ose nevojat trajnuese.


RRJETËZIM I INSTITUCIONEVE PËR VËNIEN NË JETË TË POLITIKAVE TË REJA RINDRE TË ZHVILLIMIT VENDOR



Synon realizimin e një **AKTIVITETI TË RRJETËZIMIT** me objektiv
punësimin e të rinjve përmes:

Realizimit të **workshopeve tematike** me pjesëmarrjen e
enteve publike e private.

Aktivizimit të një **rrjeti qendrash rinore** përmes realizimit
të takimeve dhe workshop-eve me përfaqësues e
përfitues të qendrave rinore ku bashkëndahen
eksperienca dhe praktika të mira të
realizuara në nivel kombëtar.



ZHVILLIM I KOMPETENCAVE SOCIALE DHE AFTËSIVE QË RRSIN PËRFSHIRJEN SOCIALE

Me qëllim **STIMULIMIN E POTENCIALEVE TË TË RINJVE**, përmirësimin e kompetencave të tyre personale dhe njohjen e nevojave dhe interesave të tyre reale do të procedohet me:

Krijimin pranë qendrës së fëmijëve (ish kinema Vullnetari)
të një hapsire ndërveprimi të strukturuar si një
Qendër Multimediale që ofron akses në
instrumenta ndërveprimi.

Organizimin e një **laboratori të shprehjes artistike** dhe fuqizimit individual përmes kurseve të muzikës, dancit, teatrit me ekspertë trajnues.

MUNDËSI TË FORMIMIT PROFESIONAL QË PËRMIRËSOJNË PËRFSHIRJEN NË PUNËSIM



Do të mbështetet aksesimi në tregun e punës së të rinjve në situata vështirësie përmes metodologjisë së **"CIKLI I KËSHILLIMIT DREJT PUNËSIMIT"**, të ofrimit të formimit profesional i cili përfshin:

Regjistrimi në kurse profesionale të realizuara në strukturat e Tjeter Vizion e/ose pranë Qendrës së Formimit Profesional në Elbasan si : kuzhinë, rrobaqepsi, gjuhë angleze, informatikë, parukeri etj

Dhënien e granteve për ndjekjen e "trainimit në punë" pranë sipërmarrjeve private, sipas nevojave të tregut të punës, kompetencave të përfituesve dhe nevojave të biznesit.

Asistencë teknike në favor të të rinjve lidhur me start up të ndërhyrjeve ose mbështetje e aktiviteteve ekzistuese (business plan, aspektet juridike, administrim, normat e cilësisë, tregtia dhe marketingu on line) si dhe grante për mbështetjen e kostove fillestare të investimit.

BASHKËVEPRIM
Proces
në grup

VENDIMARRJE
Cikli i
këshillimit

KAPACITETE
Praktika
dhe formim
profesional

CIKLI I KËSHILLIMIT DREJT PUNËSIMIT

Për të mbështet individët në nevojë dhe të krijoje perspektiva profesionale për t'u integruar në tregun e punës.

Në qendër të kësaj për qasje është ecuria e individëve, fuqizimi dhe përgatitja e tyre për tregun e punës ose vetëpunësimi tyre.

Në këtë proces individët mbështeten hap pas hapi nga një këshillues.

PREZANTIMI I CIKLIT
TË KËSHILLIMIT DHE
HAPAVE TË TIJ

FORMIMI I GRUPEVE
(RREGULLAT, AKTIVITETET,
DINAMIKAT, SFIDAT)

TAKIME JAVORE NË GRUP

PJESËMARRJE, AKTIVITETE
DHE PUNË NË GRUP

SHKËMBIM EKSPERIENCASH
NË GRUP

TË NXËNIT, DHE
MBËSHTETJE INDIVIDUALE

MBËSHTETJE DHE
ZHVILLIM I KOMUNITETIT

BASHKËVEPRIM PROCES NË GRUP

Përparimi i grupit dhe individëve është i përbashkët dhe reflektohet tek grupi. Pjesëmarrësit e shfrytëzojnë këtë mjedis për të zhvilluar aftësi sociale (komunikim, prezantim, informata kthyesë, diskutime) dhe individuale (aftësi për të dhënë dhe për të pranuar kritikë, mësim prej të tjerëve).

Në të njëjtën kohë pjesëmarrësit përgatisin aktivitete për t'i realizuar në komunitet. Aktivitetet të cilat realizohen shërbejnë si lidhje e rëndësishme me prindër, miq, fqinjët dhe ofrojnë mundësi për zhvillim të kompetencave sociale, metodologjike dhe individuale.

VENDIMMARRJE CIKLI I KËSHILLIMIT

Pasi t'i qartësojnë interesat e tyre dhe pasi të krijojnë vizion real dhe motivues për ardhmërinë e tyre profesionale, pjesëmarrësit fillojnë të dizenojnë planin e tyre individual për zhvillim (PIZh). PIZh u shërben si instrument për planifikim dhe vete-kontroll. Ai përmban planifikim konkret të të gjithë hapave të veçantë dhe mënyrën si ato janë të ndërlidhur me njëri - tjetrin për të realizuar qëllimet e caktuara, mjetet financiare etc. Pjesëmarrësit të cilët dëshirojnë të vetëpunësohen ose të fillojnë biznesin e tyre, do t'i zbatojnë planet e biznesit ose të do të ndërlidhen me këshilla për biznes-plane.

FUQIZIMI I KAPACITETEVE
INDIVIDUALE

VETËPREZANTIMI DHE
APLIKIMI

PLANI INDIVIDUAL
I ZHVILLIMIT

BUXHETI PËR ZBATIMIN E
PLANEVE TË ZHVILLIMIT
INDIVIDUAL

REGJISTRIMI NË ZYRAT
E PUNËS

MBËSHTETJA E
INICIATIVAVE PERSONALE

HARTIMI I PLANEVE TË
BIZNESIT

GATISHMËRIA PËR TË HYRË
NË TREGUN E PUNËS

PËRZGJEDHJA E DFRUESVE
TË TRAJNIMEVE DHE
RËNIA DAKORD
PËR KUSHTET

QASJA DHE NEGOCIMI
ME BIZNESET

PRAKTIKA PROFESIONALE
NË BASHKËPUNIM ME
BIZNESIN LOKAL

MUNDËSI PUNËSIMI NË
BASHKËPUNIM ME
ZYRËN E PUNËS

TRAJNIME PËR SHKATHTËSI
FUNKSIONALE

KAPACITETE PRAKTIKA dhe FORMIM PROFESIONAL

Trajnimet ose kurset për arsim profesional, mund të jenë hap i domosdoshëm për zhvillimin e kompetencave profesionale.

Nëse jo, puna praktike mund të jetë mundësi e dytë. Pas kësaj, për shumicën e pjesëmarrësve, praktika afatgjatë prej tre (3) deri gjashtë (6) muaj paraqet mundësi të mira për të aplikuar njohuritë profesionale dhe për të fituar përvojë në punë.

Në të njëjtën kohë pjesëmarrësit forcojnë shkathtësitë funksionale themelore që nevojiten për lexim, shkrim, matematikë dhe TIK, të cilat do të luajnë rol të rëndësishëm në profesionin e tyre dhe për të marrë pjesë në proceset jetësore.

KOMPETENCAT THEMELORE

CIKLI I KËSHILLIMIT
ËSHTË I DIZENJUAR NË
BAZË TË KONCEPTIT
TË **KOMPETENCAVE**
MË TË RËNDËSISHME,
TË CILA JANË TË
STRUKTURUARA
NË **4**
DIMENSIONE

1.Kompetencat sociale:

Përfshijnë njohuri dhe shkathtësi, të cilat i mundësojnë një personi të veprojë në mënyrë adekuate në raport me kolegët, anëtarët e ekipit dhe personave përgjegjës, si p.sh. shkathtësi komunikimi, kapacitetet për punë ne grup, imazh i ndividual dhe mirësjellje.

2.Kompetencat individuale:

përfshijnë qëndrim për iniciativë, motivim dhe kontroll të sjelljes individuale në situata të ndryshme. Kompetencat

individuale janë karakteristika personale të cilat janë të dobishme, jo vetëm në kontekstin e punës, por edhe interesin personal, përkushtimin, vetëdisiplinën dhe aftësinë për të punuar në mënyrë të pavarur.

3.Kompetencat metodologjike:

janë të gjitha njohuritë dhe shkathtësitë, të cilat i mundësojnë personit ta planifikojë dhe organizojë punën e tij në mënyrë racionale dhe t'i kryejë detyrat në mënyrë të strukturuar, metodologjike dhe të orientuar për të arritur qëllimin.

4.Kompetencat profesionale:

përfshijnë njohuritë profesionale, aftësinë për të kuptuar dhe aplikuar njohuritë specifike, si dhe përshtatjen e tyre me standardet e punës, që zakonisht janë të ndryshueshme.

CIKLI I KËSHILLIMIT

1

MOBILIZIMI I
RESURSEVE



2

FORMIMI I
GRUPEVE

HULUMTIMI I
TREGUT TË
PUNËS

3

4

PRAKTIKA E
SHKURTË



5

PLANI PËR
ZHVILLIM
INDIVIDUAL

AKTIVITETE NË
KOMUNITET

6

TRAJNIMI
PROFESIONAL

7

9

NIS NJË
BIZNES

TRAJNIMI PËR
SHKATHËSI
FUNKSIONALE

8